



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 maj 2014  
Nr.ref.: RK 629/14

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**Rastin Nr. KI232/13**

Parashtrues

**Fatos Kakeli**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev.  
Mlc. nr. 197/2011, të 14 majit 2013**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa u dorëzua nga z. Fatos Kakeli (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Prizren, i përfaqësuar nga z. Nexhat Helshani, avokat nga Prizreni.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. nr. 197/2011, të 14 majit 2013, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit më 31 maj 2013.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi pretendon se janë shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të mos zbulohet identiteti i tij për shkak të *“përzierjes së shumë personave që kanë ndikuar në vendime”*.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

6. Më 27 dhjetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 15 janar 2014, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI232/13, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI232/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 27 janar 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.
9. Më 14 mars 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Më 29 maj 2003, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi C. nr. 425/01) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës për anulimin e kontratës së shitblerjes së paluajtshmërisë. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Prizren.
11. Më 1 qershor 2005, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktvendimi Ac. nr. 409/2003) e aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, e anuloi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren dhe e ktheu lëndën në rigjykim.

12. Më 6 qershor 2007, Gjykata Komunale në Prizren (Aktgjykimi C. nr. 505/05) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.
13. Më 14 maj 2013, Gjykata Supreme (Aktgjykimin Rev. Mlc. nr. 197/2011) e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 333/2009, të 13 prillit 2011, dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren, C. nr. 762/2008, të 7 majit 2009.
14. Për më tepër, nuk ishte dorëzuar asnjë dokument dhe informatë përcjellëse lidhur me arsyet që parashtruesit të mos i zbulohet identiteti.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“është cenuar parimi i mbrojtjes së të drejtës në pronë nga ana e instancave gjyqësore”* dhe se *“është cenuar parimi themelor që ka të bëjë me gjykim të drejt dhe të pa anshëm, ngase vendimi është nxjerr si rezultat i veprës penale...”*.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

16. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, ajo duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:
 

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”*.
18. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:
 

*“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: b) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajve nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi, ose [...]”*.
19. Aktgjykimi i fundit i Gjykatës Supreme, Rev. Mlc. nr. 197/2011, ishte marrë më 14 maj 2013, dhe i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 31 maj 2013, përderisa parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 27 dhjetor 2013, d.m.th. më shumë se katër (4) muaj nga dita kur parashtruesit i ishte dorëzuar vendimi i Gjykatës Supreme.
20. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme si e paafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.
21. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për moszbulimin e identitetit të tij, Gjykata e refuzon atë si të pabazuar, sepse nuk është ofruar asnjë dokument që do të mbështeste arsyet për moszbulimin e identitetit të parashtruesit të kërkesës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 14 mars 2014, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën e parashtruesit për moszbulimin e identitetit të tij;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Robert Carolan



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

  
Prof. dr. Enver Hasani